



REPUBLIKA E SHQIPERISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS**  
**DEKANATI**

**NJOFTIM**

**PËR STUDENTËT DIPLOMANTË PËRSËRITËS**

Për të gjithë studentët diplomantë përsëritës (diplomë me 30 kredite) të cilët kanë:

1. realizuar të gjithë frekuentim/detyra/projekte të lëndëve (pra kanë vetëm provime)
2. realizuar të paktën kontrollin 1 dhe 2 të studios së diplomës

Sqarojmë se:

1. për studentët të cilët kanë nisur temën e diplomës në vitin 2021-2022, duhet që në sezonin e dimrit 2024 të kenë realizuar kontrollin 3.
2. për studentët të cilët kanë nisur temën e diplomës në vitin 2022-2023, duhet që në sezonin e vjeshtë 2024 të kenë realizuar kontrollin 3.

Në rastet se brenda këtij afati nuk përmbyllen detyrimet e mësipërme, atëherë ato do të nënshtrohen planit të ri mësimor të cilët ata do të bashkangjiten në vitin përkatës, duke ndjekur të gjitha detyrimet që lindin nga ndryshimi i planeve mësimore. Efektet e planit të ri mësimor do të nisin në tetor 2024 me fillimin e vitit akademik 2024-2025.

Studentët të cilët kanë ende lëndë të tjera për të frekuentuar përfshirë dhe studjon e diplomës, do të nënshtrohen planit të ri mësimor.